



Prishtinë: 19.12.2008

Kodi i ZRRE-së: V\_153\_2008

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_R\_164\_12\_08

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_R\_164\_12\_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2008 nxori këtë:**

### VENDIM

**PRANOHET** ankesa e konsumatorit Shkodran Mazrekaj, Supermarketi "Ardiani" (shifra e konsumatorit DPR – 90002208) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK në ZRRE me datë 14.07.2008 ka apeluar përgjigjen e Departamentit për Konsumatorë në KEK të datës 04.07.2008, lidhur me ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 20.02.2007, ekipi i autorizuar i KEK-ut ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik Nr. 6135809 dhe ka vendosur njehsorin nr. 4411126.  
**Provë:** Procesi mbi heqjen dhe ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 7 të datës 20.02.2007.
- Me datë 12.03.2007, qendra e kalibrimit ka bërë kontrollimin detal të njehsorit të konsumatorit nr. 6135809, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka të manipuluar.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 5/2 të datës 12.03.2007.
- Me datë 21.03.2007, qendra e kalibrimit ka bërë shqyrtimin e njehsorit elektrik, ku ka bërë matjet e njehsorit.  
**Provë:** Protokolli mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 625 të datës 21.03.2007.
- Me datë 24.01.2008, ekipi i autorizuar i KEK-ut ka regjistruar te dhënat teknike të pikës matëse të konsumatorit, dhe ka regjistruar seksionin e kabllit, 4 x 4 mm<sup>2</sup>.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 022770 të datës 24.01.2008.
- Me datë 05.03.2008, KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar në vlerë prej 5,580.72 €.  
**Provë:** Fatura DPR08HP04877 të datës 05.03.2008.
- Me datë 26.06.2008, konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK.
- Me datë 04.07.2008, departamenti për konsumatorë në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit dhe duke u thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe



procesverbalin e kalibrimit.

**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 04.07.2008.

- Me datë 14.07.2008, konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut dhe konsumatorit, dhe ka vërejtur se:

- ✓ Në procesverbalin e Qendrës së Kalibrimit nr. 5/12 të datës 12.03.2007 gjatë kontrollimit detal të njehsorit elektrik është theksuar se njehsori elektrik vulat (shtetërore) i ka të manipuluar, por që komisioni nuk ka hasur në ndonjë parregullsi tjetër tek njehsori i konsumatorit.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 5/12 të datës 12.03.2007
- ✓ Sipas analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të vjetër dhe njehsor të ri gjatë sezoneve të verës dhe dimrit vërehet se konsumatori nuk ka ndonjë ndryshim të konsumit mes njehsorit të vjetër dhe të ri.  
**Provë:** Rrjedhja e energjisë aktive.
- ✓ Procesverbali i Qendrës së Kalibrimit është bërë me datë 12.03.2007 ndërsa KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me datë 05.03.2008, që do të thotë se KEK-ut iu është dashur një vjet që të ngarkoj konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar edhe atë vetëm duke u thirrur në procesverbalin e kalibrimit.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 5/12 të datës 12.03.2007 dhe Fatura DPR08HP04877 e datës 05.03.2008
- ✓ KEK-u nuk ka bërë analiza të rrjedhjes së energjisë aktive për konsumatorin e ka ngarkuar për shfrytëzim të paautorizuar vetëm sipas procesit të kalibrimit.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmimeve të paraqitura i rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së,

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Ta shkarkojë konsumatorin nga fatura DPR08HP04877 në shumë prej 5,580.72 €, e ngarkuar për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---